

**Gjykata Themelore në Mitrovicë**  
**P. No. 134/2015**

**02.11.2015**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**

Gjykatësja e EULEX-it Iva Niksic si Gjykatëse e vetme gjykuese me pjesëmarrjen e zyrtarit ligor të EULEX-it Agron Kelmendi si procesmbajtës, në çështjen penale kundër:

1. **B. H. – i pandehur**, emri i babës H., emri i nënës N. K., i lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, banon në \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, Kosovë, dhe adresa e dytë e banimit është rruga “\_\_\_\_\_” nr. \_\_\_, \_\_\_, \_\_\_, me nënshtetësi Kosovare por edhe \_\_\_\_\_, i martuar, baba i fëmijëve të rritur, me shkollë të mesme të kryer, punëtor me të hyra mujore prej 250-300€,

i akuzuar për:

kryerjen e veprës penale “Pranim i Mallrave të Vjedhura” në kundërshtim me nenin 272 (1) KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK-së;

kryerjen e veprës penale “Pranim i Mallrave të Vjedhura” në kundërshtim me nenin 272 (1) KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK-së në bashkëkryerje me **E. M.**

dhe

“Dëmtim i Pronës së Luajtshme” në kundërshtim me nenin 260 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së CCK në bashkëkryerje me **A. I.;**

2. **E. M.-i pandehur**, emri i babës F. emri i nënës A. D., i lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, dhe jeton në rrugën “\_\_\_\_\_” nr. \_\_\_, komuna e \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ i Kosovës me nënshtetësi Kosovare, i pamartuar pa fëmijë, me shkollë fillore të kryer, punëtor, punon në ndërtimtari të hyra mesatare prej 250-300,

i akuzuar për

kryerjen e veprës penale “Pranim i Mallrave të Vjedhura” në kundërshtim me nenin 272 (1) KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK-së në bashkëkryerje me **B. H.**

dhe

3. **A. I.-i pandehur**, emri i babait D., emri i nënës A. F., i lindur më \_\_\_\_\_, në komunën e \_\_\_\_\_, banon në rrugën “\_\_\_\_\_” nr. \_\_\_, \_\_\_\_\_ i Kosovës me nënshtetësi Kosovare, i pa martuar, pa fëmijë, me shkollë të mesme të kryer, auto elektricist me të hyra mesatare prej rreth 300 euro,

i akuzuar për

kryerjen e veprës penale “Dëmtim i Pronës së Luajtshme” në kundërshtim me nenin 260 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së në bashkëkryerje me **B. H.**;

të gjithë të akuzuar me aktakuzën PP Nr: 158/11 të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës të datës 18 qershor 2012, dhe e dorëzuar në gjykatë më 26 qershor 2012 dhe e ndryshuar me datën 8 prill 2014;

pas mbajtjes së seancave të rregullta dëgjimore, të hapura për publik, me datat 26 dhe 27 mars, 15 dhe 16 prill dhe 18 maj në çështjen P.nr. 11/2013 dhe veçimin e procedurave të përmendura në çështjen aktuale lidhur me të pandehurit (sipas nenit 36, paragraf 1 të kodit të procedurës penale të Kosovës – KPK) dhe ndarjen e proceduara kundër tyre dhe vënia e emrit të ri lëndor P.nr.134/2015 seancat kryesore gjyqësore ta mbajtura me datat 7, 13, 22, 23 dhe 27 tetor 2015, në praninë e prokurorit të EULEX-it, të gjithë Të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës;

në pajtim me nenin 364 par 1, nën-paragraf 1.3 dhe nen 365 i KPPK, më 02 nëntor 2015 në seancën publike dhe në prani të Prokurorit të EULEX-it,

nxjerr si në vijim këtë:

## **AKTGJYKIM**

I. I pandehuri **B. H.** shpallet

### **FAJTOR**

për akuzën sipas pikës V të aktakuzës , sepse është vërtetuar se ka kryer këtë vepër penale:

- Duke e ditur se vetura \_\_\_\_\_, ngjyrë e zezë, e cila mban numrin e regjistrimit nr. \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_ me numër shasic \_\_\_\_\_, në pronësi të palës së dëmtuar E. J., është vjedhur, të njëjtën e kishte blerë gjatë periudhës nga 15 marsi 2011 deri në nëntor 2011 nga një person(a) i/(të) paidentifikuar për një çmim shumë më të ulët sesa ishte vlera reale (e tregut) dhe gjatë nëntorit 2011 e kishte blerë dhe vetë e kishte vozituar deri te autoshopi “\_\_\_\_\_” me pronar A. I. në rrugën “\_\_\_\_\_” në \_\_\_\_\_ i cili i kishte pranuar udhëzimet nga **B. H.** dhe e kishte çmontuar me qëllim ta shiste për pjesë (pjesët e brendshme dhe të jashtme) veturave të tjera të së njëjtës markë, ngjyrë bronzi, e cila ishte djegur më herët nga persona të panjohur në \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ dhe të cilën e kishte vozitur **B. H.** dhe e kishte transportuar për në autoshopin e **A. I.**;

Përmes kësaj ai kishte kryer veprën penale “Pranimi i Mallrave të Vjedhura” ” në kundërshtim me nenin 272 (1) KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe kështu që:

**B. H.** dënohet me 10 (dhjetë) muaj burgim.

II. I pandehuri **B. H.** shpallet

## FAJTOR

për akuzën sipas pikës VI të aktakuzës , sepse është vërtetuar se ka kryer këtë vepër penale:

- Derisa dihet se vetura e markës \_\_\_\_\_, ngjyrë e zezë, me tabela \_\_\_\_\_ me numër \_\_\_\_\_, e paregjistruar në Kosove dhe statusi i saj është i paqartë, është vjedhur sipas marrëveshjes me pronarin e saj E. M. i cili pretendohet se e ka blerë në tetor/nëntor 2011 në \_\_\_\_\_ nga personi i pанjohur me emrin “\_\_\_\_\_” e cili e ka marrë nga ai dhe ka aranzhuar riparimin e pajisjeve të saj elektrike dhe gjatë nëntorit 2011 pasi e kishte sjellë E. M. nga \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, ai e kishte sjellë këtë veturë te autoshopi “\_\_\_\_\_” në rrugën “\_\_\_\_\_” në \_\_\_\_\_, sidoqoftë policia ka ardhur të njëjtën ditë aty dhe e kishte marr automjetin.

**Me këtë, në bashkëkryerje me E. M., ai ka kryer veprën penale “Pranimi i mallrave të vjedhura” në kundërshtim me nenin 272 (1) e lexuar me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës the (KPK) dhe si rrjedhojë:**

- **B. H. i dënohet me dhjetë (10) muaj burgim.**

Bazuar në nenin 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) nën-paragrafi 2) të KPK-së për të dy veprat penale që i atribuohen **B. H.** dhe duke marrë parasysh dënimet veç e veç të shqiptuara për këto vepra, si rrjedhojë ai dënohet me **dënimin unik prej tetëmbëdhjetë (18) muaj,**

por, në pajtim me nenin 43 paragrafi (1) dhe nenin 44 paragrafi (2) të KPK-së, ky **dënim nuk ekzekutohet nëse i dënuari B. H. nuk kryen një vepër tjetër penale për kohën e verifikimit prej tre (3) vjetësh.**

Bazuar në nenin 73 paragrafi (1) të KPK-së koha e kaluar në paraburgim dhe gjatë heqjes së lirisë në lidhje me të **pandehurin B. H.**, përkatesisht prej **14.12.2011** deri më **06.04.2012** të përfshihet në dënimin me burgim në rast të heqjes së dënitit me kusht dhe të ekzekutimit të dënitit.

### I. Andaj i pandehuri E. M. shpallet

## FAJTOR

Për akuzën sipas pikës VI. të aktakuzës, sepse është vërtetuar se ai ka kryer veprimin e mëposhtëm:

- Gjersa ishte në dijeni se vetura e prodhimit \_\_\_\_\_, me ngjyrë të zezë, me targa të \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_-, e paregjistruar në Kosovë dhe pa status të qartë, ka qenë e vjedhur, e kishte blerë atë gjatë Tetorit/Nëntorit 2011 në \_\_\_\_\_ nga një person i panjohur i quajtur ‘\_\_\_\_’, dhe sipas marrëveshjes me B. H., gjatë Nëntorit 2011, ai ia kishte dorëzuar veturën atij në komunën e \_\_\_\_\_ për të organizuar riparimin e pajisjes së saj elektrike nga A. I. në punëtorinë e tij ‘\_\_\_\_’ në rrugën \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, mirëpo në po të njëjtën ditë kur B.H. e kishte sjellë atë te punëtoria e A. I., kishte ardhur Policia dhe e kishte marrë veturën.

Me këtë, në bashkëkryerje me B. H., ai ka kryer veprën penale “Pranimi i mallrave të vjedhura” në kundërshtim me nenin 272 (1) e lexuar me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës the (KPK) dhe si rrjedhojë:

- E. M. dënohet me dhjetë (10) muaj burgim,

por, në pajtim me nenin 43 paragrafi (1) dhe nenin 44 paragrafi (2) të KPK-së, ky dënim nuk ekzekutohet nëse i dënuari E. M. nuk kryen një vepër tjetër penale për kohën e verifikimit prej dy (2) vjetësh.

Bazuar në nenin 73 paragrafi (1) të KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim gjatë heqjes së lirisë në lidhje me të pandehurin E. M., përkatesisht prej 15.12.2011 deri më 21.03.2012 të përfshihet në dënimin me burgim në rast të heqjes së dënimit me kusht dhe të ekzekutimit të dënitit.

**II.** Bazuar në nenin 364 pika 1.3) të **Kodit të Procedurës Penale (KPP )**, të pandehurit A. I. dhe B. H.

**LIROHEN**

ngaakuza e përshkruar në pikën VII. të aktakuzës, sepse nuk është vërtetuar se ata kanë kryer veprimin e mëposhtëm:

- Gjersa ishin në dijeni se vetura e prodhimit \_\_\_\_\_, me ngjyrë të zezë, me targa nr. \_\_\_\_\_, me numër të shasisë \_\_\_\_\_ (shih Pikën 5) e blerë nga **B. H.**, gjatë periudhës prej 15 marsit 2011 deri në nëntor të vitit 2011 nga personi(at) e paidentifikuar për një çmim që ishte dukshëm më i lirë sesa çmimi i tregut (vlera e tregut), në pronësi të një personi tjetër, gjatë muajit nëntor 2011 **B. H.** ia kishte sjellë atë **A. I.** duke e vozitur vetë tek punëtoria e tij “\_\_\_\_\_” në rrugën \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, me qëllim që ta bënte atë të papërdorshme duke e ndarë atë (çmontuar) në pjesë, çfarë sipas marrëveshjes së tyre **A. I.** e kishte bërë, me synimin që ta shiste atë për pjesë rezervë por më 14 dhjetor 2011 ai ishte kapur nga Policia.
- Dhe me këtë në bashkëkryerje kishte kryer veprën penale Dëmtimi i pasurisë së luajtshme në kundërshtim me nenin 260 (1) të lexuar me nenin 23 të KPK-së.

I pandehuri **A. I.** ka të drejtë për kompensim në pajtim me nenin 529, paragrafi 1 të KPP-së për kohën që ka kaluar në paraburgim.

**V.** Bazuar në nenin 463 paragrafi (2) të KPP-së, pala e dëmtuar **E. J.** ftohet të kërkojë çfarëdo kërkese për kompensim në lidhje me këtë lëndë përmes procedurës civile në gjykata.

**VI.** Bazuar në nenin 451, paragrafi (1) dhe nenin 453, paragrafët (1) dhe (4) të KPP-së, i pandehuri **B. H.** duhet t'i paguajë 500,00 (pesëqind) Euro si pjesë të shpenzimeve të procedurës penale, por lirohet nga detyrimi për të kompensuar shpenzimet e mbetur. I pandehuri **E. M.** duhet t'i paguajë 200,00 (dyqind) Euro si pjesë të shpenzimeve të procedurës penale, por lirohet nga detyrimi për të kompensuar shpenzimet e mbetur.

Të pandehurit duhet të kompensojmë shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim merr formën e prerë.

**VII.** Bazuar në nenin 454 paragrafi (1) të KPP-së, në lidhje me të pandehurin A. I., shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 450 paragrafi (2) pikat 1-5) të KPP-së, shpenzimet e tij të domosdoshme si dhe kompensimi i shpenzimeve të domosdoshme të avokatit të tij mbrojtës, të paguhen nga mjetet e buxhetit.

**Gjykata Themelore në Mitrovicë**

**Zyrtari ligjor  
Agron Kelmendi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese  
Iva Niksic**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Palët në këtë rast kanë 15 ditë nga dorëzimi i këtij aktgjykimi për të ushtruar ankesë në pajtim me nenet 380(1) dhe 381(1) të KPP-së. Çdo ankesë duhet të paraqitet në gjykatën e shkallës së parë sipas nenit 388(1) të KPP-së.